



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

PËR

**DHURIMIN E APARTAMENTEVE FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE,
SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Dhurimin e 17 apartamenteve, në pronësi të Bashkisë Tiranë të ndodhura në njësinë administrative nr.1, Tiranë, për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019 edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”.

Neni 2

Këshilli Bashkiak Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore jep pëlqimin për tjetërsimin e këtyre pasurive të paluajtshme në favor të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas parashikimeve të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Apartamentet që dhurohen për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të

datës 26.11.2019, hiqen nga lista e pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tiranë ose të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

1. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, brenda 2 (dy) ditëve pune, lëshon certifikatën e përdorimit për objektet e përcaktuara në nenin 1 të këtij akti normativ sipas gjendjes dhe dokumentacionit ekzistues të objektit.
2. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, përjashtimisht sipas parashikimeve të këtij akti normativ, Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen fillimisht regjistrimin e apartamenteve që do të dhurohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të Bashkisë Tiranë dhe më pas kryen veprimet e nevojshme për kalimin dhe regjistrimin e tyre në pronësi të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2011.
3. Dhurimi të realizohet nëpërmjet kontratës së dhurimit, sipas parashikimeve të Kodit Civil.
4. Kontrata nënshkruhet nga kryetari i Bashkisë Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe nga përfaqësuesit e familjeve përfituese, të përcaktuara në listën e dërguar nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.
5. Apartamenti i dhuruar regjistrohet në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve të familjes përfituese.
6. Çdo shpenzim procedural për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë paguhen nga Bashkia Tiranë ose njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Strukturat shtetërore të vendosin në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë. Të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente mbulohen nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Ngarkohen kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRIT TË FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ